



Një udhëzues për vaksinimin COVID-19

Të gjitha gratë në moshë riprodhuese, ato që janë aktualisht shtatzënë ose që ushqejnë me gji

Ju duhet ta lexoni këtë para se të shkoni për vaksinim

Gjeni më shumë në
nhs.uk/CovidVaccine

Vaksinat COVID-19 të disponueshme në Mbretërinë e Bashkuar janë treguar efektive dhe kanë një profil të mirë sigurie.

Këto vakcina nuk përmbajnë koronavirus aktiv dhe nuk mund të infektojnë një grua shtatzënë ose foshnjën e saj të palindur në bark.

VAKSINIMI COVID-19 në shtatzëni

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) ka këshilluar që grave shtatzëna duhet t'u ofrohen vaksinat COVID-19 në të njëjtën kohë me njerëzit e së njëjtës moshë ose grup rreziku. Në SHBA, rreth 90,000 gra shtatzëna janë vaksinuar kryesisht me vaksinat Pfizer dhe Moderna dhe nuk janë identifikuar shqetësime të sigurisë.

Të dhënat mbi vaksinat COVID-19 po rishikohen vazhdimisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe organet rregullatore në MB, SHBA, Kanada dhe Evropë.

Vaksinat Pfizer dhe Moderna janë vaksinat e preferuara për gratë shtatzëna të çdo moshe, që vijnë për dozën e tyre të parë.

Cilado që tashmë ka filluar vaksinimin dhe i është ofruar një dozë të dytë gjatë shtatzënisë, duhet të marrë një dozë të dytë me të njëjtën vaksinë, përveçse nëse ka pasur një efekt anësor serioz pas dozës së parë.

A është sëmundja COVID-19 serioze në shtatzëni?

Megjithëse rreziku i përgjithshëm nga sëmundja COVID-19 në gratë shtatzëna dhe foshnjat e tyre është i ulët, në shtatzëninë e mëvonshme disa gra mund të sëmuren seriozisht dhe kanë nevojë për trajtim spitalor.

Gratë shtatzëna me COVID-19 kanë një rrezik më të lartë të pranimit në kujdesin intensiv sesa gratë e së njëjtës moshë që nuk janë shtatzënë. Gratë me sëmundje COVID-19 kanë gjithashtu 2-3 herë më shumë gjasa t'i lindin foshnjat e tyre herët, sesa gratë pa COVID-19.

Gratë shtatzëna me probleme klinike afatgjata, janë në rrezik edhe më të lartë për të pësuar komplikime serioze nga COVID-19.

Faktorët e rrezikut për gratë shtatzëna

Nëse vuani nga ndonjë sëmundje afatgjatë si:

- probleme imuniteti
- diabeti
- tension i lartë i gjakut
- sëmundje të zemrës
- astma

Ose nëse jeni

- mbipeshë
- mbi moshën 35 vjeç
- në tremujorin e tretë të shtatzënisë (mbi 28-javëshe)
- me prejardhje etnike nga afro-karibet dhe ato aziatike

Ju jeni më të rrezikuara nga COVID-19 sesa gratë e së njëjtës moshë që nuk janë shtatzënë.

Çfarë do të thotë kjo për mua?

Mbetja shtatzënë

Nuk ka nevojë të shmangni mbetjen shtatzënë pas vaksinimit me COVID-19.

Nuk ka asnjë provë që vaksinat COVID-19 kanë ndonjë efekt në fertilitetin, ose shanset tuaja për të mbetur shtatzënë.

Nëse jeni shtatzënë

Vaksinat COVID-19 u ofrojnë grave shtatzëna mbrojtjen më të mirë kundër sëmundjes COVID-19, e cila mund të jetë serioze në shtatzëninë e mëvonshme për disa gra.

Doza e parë e vaksinës COVID-19 do t'ju japë mbrojtje të mirë. Juve ju duhet doza e dytë për të marrë një mbrojtje më të qëndrueshme. Ju nuk keni nevojë ta vononi këtë dozë të dytë.

Nëse tashmë keni marrë një dozë të parë të vaksinës COVID-19 pa pësuar ndonjë efekt serioz anësor, mund të bëni dozën tuaj të dytë me të njëjtën vaksinë, kur kjo të ofrohet.

Nëse doza juaj e parë ishte vakcina AstraZeneca, duhet të merrni parasysh informacionin në këtë broshurë www.gov.uk/government/publications/covid-19-vaccination-and-blood-clotting.

Asnjë vaksinë nuk është 100% efektive, prandaj është e rëndësishme të vazhdoni të ndiqni udhëzimet aktuale kombëtare.

Për të mbrojtur veten dhe familjen tuaj, miqtë dhe kolegët, ju DUHET akoma të:

- praktikoni distancimin shoqëror
- vini një maskë në fytyrë
- lani duart me kujdes dhe shpesh
- hapni dritaret për të futur ajrin e pastër
- ndiqni udhëzimet aktuale

Ushqyerja me gji

Përfitimet e ushqyerjes me gji janë të njohura.

JCVI ka rekomanduar që vaksinat mund të merren gjatë ushqyerjes me gji. Kjo është në përputhje me rekomandimet nga SHBA dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.


Si të gjitha ilaçet, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore të zakonshme. Është mirë të siguroheni që të dini çfarë të prisni pasi të keni bërë vaksinën, veçanërisht nëse keni pasur fëmijën tuaj, ose keni fëmijë të tjerë për t'u kujdesur.

Ju lutemi lexoni broshurën 'çfarë të prisni pas vaksinimit tuaj COVID' www.gov.uk/government/publications/covid-19-vaccination-what-to-expect-after-vaccination.

Kolegji Mbretëror i Obstetërve dhe Gjinekologëve (RCOG) dhe Kolegji Mbretëror i Mamive (RCM) kanë një udhëzues vendimi dhe informacione të tjera që mund të gjeni të dobishme mbi vaksinat COVID-19 dhe shtatzëninë (rcog.org.uk – www.rcm.org.uk/guidance-for-pregnant-women).

Nëse dëshironi të diskutoni për vaksinimin COVID-19, ju lutemi kontaktoni maminë, mjekun ose infermieren tuaj.

Vaksinimi, ndihma në mbrojtjen e personave më të prekshëm.



Kjo broshurë falas është gjithashtu e disponueshme në shkrimin braille, si video në BSL, shtyp të madh, si skedar audio dhe në 19 gjuhë, ju lutem vizitoni www.healthpublications.gov.uk për të shkarkuar ose porositur kopje tani.

© E drejta e autorit Crown 2021. Kodi i produktit: COV2020374V4AL Albanian 5M 1P PRILL (APS) 2021. Shëndeti Publik në Angli numri i portalit: 2021126